



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:197401

Datë: 04.02.2025

Numri i dokumentit: 06800079

C.nr.622/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.V nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatja A.H nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 554.00 euro, jashtë seancës, më datën 04.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses D.V.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D.V nga Rahoveci, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 27.06.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 217 ditë pune të ja paguajë shumën prej 434.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 27.06.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses D.V për periudhën kohore prej datës 01.04.2021 e deri më datën 26.06.2021 për 60 ditë pune në shumën prej 120.00 euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses D.V, t'i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja D.V, më datën 27.06.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 554.00 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “Bekim Sylka”, në Rahovec. Duke shtuar se për periudhën kohore nga data 01.04.2021 e deri më datën 21.11.2022, për 277 ditë të prezencës në punë, i takon

kompensimi për ushqim në punë, për një ditë pune shuma prej 2 euro, në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 11.11.2024, ka theksuar se e kontestojnë padinë në tërësi për shkak se të paditurës i mungon legjitimitete real pasiv në këtë çështje kontestimore. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesëpadia e paditësit është parashkruar. Po ashtu ka deklaruar se paditësi nuk i kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në procedurë të rregullt administrative pranë të paditurës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: Kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 12/15, e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses D.V; vërtetimit me Nr.18/2024, i datës 05.04.2024, i lëshuar nga SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec, dhe diplomës me numër 1032, të datës 22.11.2010, të lëshuar nga Fakulteti i Edukimit, të Universitetit të Prishtinës.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, si dhe a është parashkruar e drejta për të kërkuar kompensimin e ushqimit.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 12/15, e datës 01.09.2015, të lidhur ndërmjet paditëses D.V dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Bekim Sylka” në Rahovec.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me numër 15/24, i datës 05.04.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.V, në periudhën kohore prej datës 01.04.2021 e deri më datën 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 133 ditët e punës, dhe në periudhën kohore prej datës 01.01.2022 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 144 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditëses për faktin se paditësja në periudhën kohore nga data 27.06.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 217 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla

ku paditësja ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 217 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditëses D.V, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 434.00 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për periudhën kohore nga data 01.04.2021 deri me datën 26.06.2021 për faktin se padia e paditëses është dorëzuar më datën 27.06.2024, ndërsa kërkesëpadija e paditëses përfshin periudhën kohore prej datës 01.04.2021 deri me datën 21.11.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa që përfshin periudhën kohore nga data 01.04.2021 deri me datën 26.06.2021 është jashtë afatit 3 vjeçar. Andaj, gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë të paditëses D.V për periudhën kohore prej datës 01.04.2021 deri me datën 26.06.2021 për 60 ditë pune, në shumën prej 120.00 euro, e ka refuzuar si të pa bazuar.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.622/2024, më datën 04.02.2025

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.